



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 21.11.2019

RAPORT

MBI RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE FUSHË- KRUIË, BURREL DHE DURRËS

- HYRJE

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut (*në vijim "Nënkomisioni"*) në mbledhjen e datës 02.10.2019, miratoi kalendarin e punimeve të Nënkomisionit për muajin Tetor 2019. Në zbatim të pikës 3, të nenit 102 të Rregullores së Kuvendit, në kalendarin e Nënkomisionit u përfshinë tre vizita monitoruese pranë instituteve të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) në Fushë-Krujë, Burrel dhe Durrës. Nënkomisioni i realizoi vizitat përkatësisht në datat 16.10.2019 dhe 1.11.2019.

I. QËLLIMI I VIZITAVE MONITORUESE

Qëllimi i organizimit të vizitave nga Nënkomisioni, ishte verifikimi i shkallës së përmbushjes së rekomandimeve lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, të adresuara në Kuvendin e Shqipërisë nga Avokati i Popullit, dhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (*në vijim "KPT"*). Vizitat monitoruese në IEVP Fushë Krujë dhe Burrel u organizuan në bashkëpunim me Komisionerin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar (*në vijim "Mekanizimi Kombëtar"*). Secili institucion përdori metodologjinë e punës së tij dhe raportet e gjetjet janë paraqitur të veçanta. Secili institucion respektoi pavarësinë e tij në rekomandimet e adresuara.

Nënkomisioni vlerëson gatishmërinë e drejtuesve dhe stafit të institucioneve që u vizituan për për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të adresuara nga deputetët/et. Ndërkohë, Nënkomisioni rithekson parimin e saksionuar në Rregullat Evropiane të Burgjeve (2016) që pamundësitë ekonomike dhe financiare në një vend nuk mund të shërbejnë si justifikim për mosrespektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria.

II. PËRMBLEDHJE E PROBLEMATIKAVE TË KONSTATUARA DHE REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KOMITETI I KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT OSE DËNIMIT ÇNJERËZOR OSE DEGRADUES (KPT) DHE AVOKATI I POPULLIT

Në datën 17 shtator 2019 u publikua raporti i Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) mbi vizitën e tij më të fundit në Shqipëri të realizuar në nëntor të vitit 2018¹. KPT konstatoi disa problematika në institucionet objekt monitorimi nga nënkomisioni. Gjithashtu, Mekanizmi Kombëtar që funksionon pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandime konkrete për secilin institucion.

Rekomandime të KPT për institutin e ekzekutimeve të vendimeve penale Fushë-Krujë

Nga inspektimi më i fundit i Avokatit të Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, të kryer në IEVP Fushë-Krujë më datë 10.10.2018, pranë Nënkomisionit u adresuan problematikat e konstatuara si dhe rekomandimet për organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të individëve që u është hequr liria si dhe parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit:

- 1. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr.8328 dt. 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetje dhe standardi që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m2 hapësire jetike për person.*
- 2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e përdorimit të ambienteve të izolim/veçimit për të dënuarit/ paraburgosurit përtej kohës së parashikuar nga ana e komisionit të disiplinës, dhe për ndërprerjen e vendosjes për një kohë të gjatë në këto ambiente të personave që nuk janë subjekt i masave disiplinore.*
- 3. Marrjen e masave të menjëhershme për shpërndarjen e të dënuarve dhe paraburgosurve me qëndrim të gjatë nga ambientet e observimit dhe kthimin e këtij ambienti në destinacionin logjistik dhe ligjorë të përcaktuar.*
- 4. Të merren masa të menjëhershme lidhur me përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë dhe energji elektrike të institucionit.*
- 5. Të marren masa të menjëhershme për rregullimin dhe vënien në përdorim të sistemit të ngrohjes për muajt e ftohtë të vitit.*
- 6. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e situatës së mungesës së energjisë elektrike si rezultat i mbingarkesës dhe defekteve në rrjetin e brendshëm të institucionit.*
- 7. Të merren masa të menjëhershme për furnizimin me ujë të vazhdueshëm të ambienteve të jetesës së burgosurve.*
- 8. Të merren masa të menjëhershme për ndarjen e regjimeve sipas Rregullores duke shmangur kështu bashkëjetesën e një të paraburgosuri me të dënuar.*
- 9. Të merren masa të menjëhershme për mundësimin e larjes në dush me ujë të ngrohtë për të burgosurit sipas Rregullores.*

¹ Për më shumë për gjetjet e raportin, mund të lexoni në adresën zyrtare të CPT:

<https://rm.coe.int/168097986b>

10. Të merren masa të menjëhershme për sigurimin e mjekut me kohë të plotë në institucion dhe të vihet në dispozicion mjeku psikiatër, për të kryer vlerësime psikiatrike më të shpeshta dhe më të shumta në numër.
11. Të merren masa për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë dhe akomodimin në këtë sektor të burgosurit me probleme të shëndetit mendor dhe të mbahen nën mbikqyerje të vazhdueshme nga stafi shëndetësor, psiko-social dhe i sigurisë.
12. Të merren masa për të krijuar një mjedis komunikimi korrekt në respekt të standardeve me të larta të trajtimit njerëzor nga ana e personelit drejtues dhe të shërbimeve me të burgosurit.
13. Të marren masat e menjëhershme për sigurimin me karrige dhe dollape të dhomave për çdo të paraburgosur.
14. Të merren masa të menjëhershme për ndarjen e të rriturve nga ata të grup-moshës 18-21 vjeçare, duke shmangur kështu bashkëjetesën e të paraburgosurit të rritur me një 18-21 vjeçar.
15. Të merren masa për të mbajtur aktive kurset e arsimit dhe ato profesionale.
16. Të merren masa për shtimin e aktiviteteve integruese dhe social-kulturore në përgjithësi dhe në veçanti për 18-21 vjeçarët.
17. Të merren masat e nevojshme nga personeli përgjegjës për të mundësuar këshillime individuale e në grup në dhoma të planifikuara për këshillim.
18. Të merren masa për furnizimin me detergjent me qëllim higjienizimin e dhomave të banimit, ambienteve të jashtme, kuzhinës dhe magazinës së ushqimeve në mënyrë periodike.
19. Të merren masa nga ana e stafit të sektorit shëndetësor për përgjigjen në kohë të kërkesave të të dënuarve, në lidhje me vizitat mjekësore, si dhe konsultat e specializuara në qendrat spitalore.
20. Të merren masa për ofrimin e një shërbimi efikas stomatologjik me ndërhyrjet përkatëse, mbushje apo ekstraksione, duke qenë se nuk mungonin materialet dhe instrumentet dentare në dhomën e stomatologut.
21. Marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të lavanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të paraburgosurit/dënuarit.

Rekomandime të KPT për institutin e ekzekutimeve të vendimeve penale Burrel

Sipas raportit të publikuar nga KPT, në IEVP Burrel, ambientet e përbashkëta të jetesës u gjenden përsëri në gjendje të varfër riparimi. Ndërtesa e vjetër dhe lagështia e depërtuar në mure e përkeqësonin gjendjen. Për më tepër, problemet me ngrohjen vazhdonin dhe ngrohja qendrore ndizej vetëm për disa orë në ditë. Shqetësuese ishte drita artificiale e ndezur gjatë orëve të natës e cila mund të shkaktojë efekte negative të shëndetit në funksionet psikologjike, kardiovaskulare dhe/ose metabolike të të burgosurve. Nuk ofroheshin aktivitete, gjë që e bënte gjithnjë e më të dëmshme gjendjen për të burgosurit afatgjatë.

Gjithashtu, nga inspektimi më i fundit i Avokatit të Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, të kryer në IEVP Burrel, në datën 04.09.2018, u adresuan problematikat e konstatuara si dhe rekomandimet për organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të individëve që u është hequr liria si dhe parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor dhe poshtëruar.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit:

Mbylljen e I EVP Burrel

Deri në dhënien zgjidhje të rekomandimit të mësipërm, rekomandohet:

- 1. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcion tërësor të I EVP Burrel për ta sjellë në kushte banimi, duke kryer riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerje të dhomave të të dënuarve. Përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjave të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.*
- 2. Marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të paraburgosurve/dënuarve, sipas dispozitave të nenit 34 dhe 35 të Ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.*
- 3. Marrjen e masave të menjëhershme për ofrimin e shërbimit të luanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të dënuarit/paraburgosurit.*
- 4. Marrjen e masave të menjëhershme për respektimin e hapësirës personale prej 4m² për person në dhoma.*
- 5. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në ambientin e guzhinës dhe përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.*
- 6. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e sistemit të kërkesë-ankesave në institucion, duke kthyer përgjigje me shkrim të paraburgosurve dhe të dënuarve brenda afateve ligjore.*
- 7. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit/paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.*
- 8. Marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes në të gjithë sektorët, sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve.*
- 9. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.*
- 10. Marrjen e masave për kryerjen e konsultimeve më të shpeshta për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, në mënyrë që të rivlerësohet dhe saktësohet diagnoza dhe mjekimi përkatës.*
- 11. Marrjen e masave për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik.*
- 12. Marrjen e masave për shtimin e një pajisje telefonike në korridoret e seksionit të paraburgimit.*
- 13. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijë të mitur.*
- 14. Marrjen e masave për të përmirësuar mjedisin e ajrimit për t’iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim.*
- 15. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve periodike me të dënuarit/paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.*
- 16. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve dhe dhomave të përshtatshme për këshillim dhe punë individuale të personelit psiko-social me të burgosurit.*
- 17. Marrjen e masave për pajisjen e fushës së ajrimit me tendë mbrojtëse nga dielli dhe reshjet.*

Rekomandime të KPT për institutin e ekzekutimeve të vendimeve penale Durrës

Nga inspektimi më i fundit i Avokatit të Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, të kryer në IEVP Durrës më datë 30.05.2019, pranë Nënkomisionit u adresuan problematikat e konstatuara si dhe rekomandimet për organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të individëve që u është hequr liria si dhe parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit:

- 1. Marrjen e masve të menjëhershme për hidroizolim të plotë të terracës së godinës në regjimin e brendshëm të institucionit, për eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të banimit.*
- 2. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin me orenditë e nevojshme për jetesë në dhomat e banimit të të dënuarve/paraburgosurve si tavolina, karrige dhe dollapë për mbajtjen e sendeve personale.*
- 3. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin u kushteve dinjitoze për jetesë në dhomat e veçimit dhe pajisjen e tyre me tavolina, komodina, kanate për dritaret dhe zëvendësimin e xhamave të thyer.*
- 4. Marrjen e masave të menjëhershme për verifikimin e rasteve, nxjerrjen e përgjegjësive dhe plotësimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve sipas normativave mujore me detergjente dhe materiale të tjera për pastrimin dhe mbajtjen e higjenës personale dhe të ambientit në dhomat e banimit.*
- 5. Marrjen e masave për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me një mjek të përgjithshëm dhe një infermier.*
- 6. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e plotë dhe furnizimin me medikamente, për rastet e të sëmurëve akutë dhe rastet e emergjencave.*
- 7. Marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e larmisë të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjërë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave.*
- 8. Marrjen e masave të menjëhershme për dizifektimin dhe përmirësimin e cilësisë të ujit të rrjedhshëm, që furnizohet nga tubacioni i ujësjellësit.*
- 9. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e seksionit të kujdesit të veçantë, me mjetet e veçanta të kufizimit fizik dhe me të paktën një shtrat dhe një karrige kufizuese, për shkak të trajtimit mjekësor të personave me probleme të shëndetit mendor.*
- 10. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.*
- 11. Marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.*
- 12. Marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e pranisë të punonjësve të sektorit juridik dhe sektorit psiko-social në kontakte të përditëshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.*
- 13. Marrjen e masave të menjëhershme, brenda hapësirave ligjore për krijimin e mundësisë që të burgosurit me shtetësi të huaj të bisedojnë më shpesh në telefon me familjarët e tyre me shpenzimet e institucionit.*

14. Marrjen e masave të menjëhershme, në bashkëpunim me institucionet e tjera të shëndetit parësor të qytetit të Durrësit, për dezinfektimin e zonës përreth kufirit të jashtëm të këtij institucionit, për eliminimin e insekteve dhe agjentëve infektivë.
15. Marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Durrës, për ofrimin e kurseve dhe zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional me të dënuarit/paraburgosurit në këtë institucion.
16. Marrjen e masave për pajisjen e Institucionit me një autoambulancë për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Spitalin Rajonal Durrës apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

III. KONSTATIME TË NËNKOMISIONIT GJATË VIZITAVE MONITORUESE

Gjatë vizitave monitoruese, drejtuesit e institucioneve njohën anëtarët e Nënkomisionit me masat e marra në përmbushje të rekomandimeve të adresuara nga KPT dhe Mekanizimi Kombëtar si dhe për çështje që kanë nevojë të adresohen në vijimësi.

Anëtarët e Nënkomisionit monitoruan nga afër kushtet e jetesës së të dënuarve, mjediset e takimit me familjarët, të ajrimit, të shërbimit mjekësor, guzhinën, si dhe mjediset e tjera në të treja institucionet.

Gjatë vizitave monitoruese në IEVP, anëtarët e Nënkomisionit vlerësuan nëse rekomandimet ishin adresuar nga institucioni, shkalla e adresimit të tyre, vështirësitë e adresimit të pjesshëm ose të mos adresimit të rekomandimeve.

3.1 Adresimi i rekomandime në IEVP Fushë-Krujë

Ky institucion është krijuar në korrik të vitit 2008. Deri në periudhën e inspektimit më të fundit të Avokatit të Popullit, ky institucion kategorizohej burg i sigurisë së lartë. Gjatë vizitës, anëtarët konstatuan se seksioni i sigurisë së lartë ishte zhvendosur në Lezhë dhe tashmë IEVP Fushë-Krujë konsiderohet burg i sigurisë së zakonshme.

Nga 21 rekomandime të adresuara nga Mekanizmi Kombëtar rezulton se janë në marrë në konsideratë dhe janë përmbushur plotësisht 10 prej tyre, ndërsa mbeten në proces zbatimi 11 rekomandime.

Më konkretisht,

Lidhur me mbipopullin dhe kapacitetin maksimal zyrtar të kësaj IEVP-je, rezultoi një mosrakordim në shifra midis drejtuesit të I.E.V.P Fushë-Krujë dhe përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas drejtuesit të institutit, kapaciteti maksimal i IEVP Fushë-Krujë është 312 persona, ndërsa për përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë është 380 persona. Numri i personave të privuar nga liria, të vendosur në këtë institut është 384 persona. Referuar shifrës së dhënë nga drejtuesi i institucionit, rezulton që 72 persona të jenë mbi kapacitetin maksimal të godinës së institucionit, ndërsa referuar shifrës së përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë, janë 4 persona të mbipopulluar. Nga verifikimi i të dhënave zyrtare të botuara në faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rezulton se kapaciteti i institucionit është 312 persona.

Sistemi i kaldajës është instaluar, por ende nuk është vënë në punë. Çdo i dënuar ka shtratin e tij, ndonëse në disa dhoma janë vendosur 6 të dënuar. Ambjenti i takimit të të dënuarve me familjarët ka lagështirë.

Shërbimi shëndetësor për të dënuarit është me rëndësi. Lidhur me gëzimin e kësaj të drejte, rezultoi se nuk është siguruar mjeku me kohë të plotë në institucion dhe as shërbimi stomatologjik me ndërhyrjet përkatëse, ndonëse nuk mungonin materialet dhe instrumentet dentare në dhomën e stomatologut.

Për t'u vlerësuar në këtë institucion, është krijimi i një këndi lojërash në oborr për prindërimin në distancë, si dhe pasurimi i bibliotekës me 300 libra të dhuruar.

3.2 Adresimi i rekomandime në I EVP Burrel

Ky institucion është projektuar që në vitin 1937. Në bazë të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë, I EVP Burrel kategorizohet burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi. Kapaciteti aktual i burgut është për 198 persona.

Nënkomisioni konstatoi se është zbatuar rekomandimi i KPT-së për shmangien e dritës artificiale në orët e vona të natës si dhe shumica e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Lidhur me masat e marra në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe KPT-së për kushtet në I EVP Burrel, u konstatua përmbushja e rekomandimeve në lidhje me ndërtimin e rrjetit të ri të furnizimit me ujë dhe nxjerrja jashtë përdorimit të rrjetit të vjetër, tharjen e lagështirës në muret e godinës. Janë ndërtuar ambjentet e reja të tualetit dhe në çdo dhomë ka tualet. Sistemi i ngrohjes rezultoi se është funksional dhe janë marrë masat për paisje ngrohjeje ambientale në raste emergjente. Anëtarët e Nënkomisionit vlerësuan përshtatjen e dy ambjenteve me qëllim edukimin social të të dënuarve, ambjente të investuara nga komunitetet fetare.

3.3. Adresimi i rekomandime në I EVP Durrës

Ky institucion është krijuar në korrik të vitit 2007. Kushtet fillestare të paraburgimit që ofroheshin për personat që mbaheshin në këtë institucion nuk ishin mjaft të përshtatshme për trajtimin sipas standardeve evropiane dhe të drejtave të personave me liri të kufizuar. Për të përmirësuar kushtet në të cilat ndodheshin të paraburgosurit si dhe ndërtimin e një institucioni me standarde bashkëkohore, në qershor të vitit 2007, me financim të Qeverisë Shqiptare filloi ndërtimi i paraburgimit të ri. Ndërtimi i paraburgimit të ri në Durrës është objekti i parë me financim të buxhetit të shtetit që ndërtohet në sistemin penitenciar. Në fillim të muajit janar 2009 ky institucion u vu në shfrytëzim të plotë me transferimin e të paraburgosurve në institucionin e ri.

I EVP Durrës kategorizohet institucion paraburgimi, me një seksion për të mitur si dhe një seksion për personat që konsiderohen bashkëpunëtorë të drejtësisë sipas kriterëve të ligjit nr. 9205, datë 15.03.2004, “ Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

Kapaciteti i institucionit është për 300 persona. Gjatë monitorimit u konstatua se numri i personave të paraburgosur dhe të dënuarve të vendosur në këtë institucion është 295, brenda kapacitetit të godinës.

Janë zbatuar disa nga rekomandimet e Avokatit të Popullit si: plotësimi me orenditë e nevojshme për jetesë në dhomat e banimit të të dënuarve/paraburgosurve si: tavolina, karrige dhe dollapë për mbajtjen e sendeve personale, plotësimi i organikës të stafit mjekësor me një mjek të përgjithshëm (me kohë të plotë) dhe medikamentet e nevojshme.

Anëtarët e Nënkomisionit konstatuan se nuk janë marrë masat për hidroizolim të terracës së godinës në regjimin e brendshëm të institucionit dhe lagështira është e dukshme në ambientet e brendshme të banimit.

Mbeten në proces zbatimi rekomandimet e tjera të Avokatit të Popullit.

Gjatë vizitave në të tre institucionet, anëtarët e nënkomisionit vunë theksin tek nevoja e programeve sociale e profesionale për të dënuarit me qëllim integrimin e shpejtë të tyre në shoqëri, pas përfundimit të kryerjes së dënimit. Në këto institucione është mundur zhvillimi i kurseve në gjuhë të huaj, por jo i kurseve profesionale.

IV. PËRFUNDIME

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar punën e kryer nga institucionet për ekzekutimin e vendimeve penale, për të përmbushur plotësisht rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit,

1. Inkurajon drejtuesit e institucioneve të monitoruara për të vazhduar më tej me realizimin e të gjitha rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe KPT-së.
2. Vlerëson ndryshimet e propozuara nga Këshilli i Ministrave në paketën ligjore për sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale për plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor në përmbushjen e rekomandimeve për respektimin e të drejtave të personave që u është privuar liria. Në këtë kuadër, Nënkomisioni rekomandon për anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, që gjatë shqyrtimit të kësaj pakete projektligjesh të miratojnë përmirësime ligjore që adresojnë shqetësimet dhe rekomandimet përkatëse.
3. Kërkon ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve që lidhen me të drejtën e kujdesit shëndetësor për çdo person të privuar nga liria dhe angazhimin e ministrive përgjegjëse për drejtësinë dhe shëndetësinë që të adresojnë sa më shpejt ofrimin e shërbimit të munguar shëndetësor me kohë të plotë në IEVP.
4. Kërkon adresimin e zbatimit të dispozitave lidhur me personat me probleme të shëndetit mendor që sëmuren gjatë kohës që janë në institucion, ose ndaj tyre që gjykata ka dhënë masa mjekësore. Nënkomisioni i rekomandon Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë të ndjekë me vëmendje zbatimin e të

drejtave për personat me probleme të shëndetit mendor që kanë kryer një vepër penale.

5. Thekson nevojën e bashkërendimit më të mirë të punës mes ministrive përgjegjëse për drejtësinë, arsimin dhe formimin profesional me qëllim ofrimin e arsimit dhe formimeve profesionale për të gjithë të dënuarit.
6. Thekson nevojën e rregullimit të punës së të dënuarve me akte nënligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nënkomisioni rekomandon inkurajimin e bizneseve nga ministritë përgjegjëse që të ofrojnë më shumë mundësi punësimi për të dënuarit në burgje dhe jashtë tyre dhe shpreh gatishmërinë për të nxitur përgatitjen e paketës ligjore dhe zbatimin e saj.
7. Kërkon vëmendjen e veçantë në trajtimin e të dënuarve të rinj nga drejtuesit dhe stafi i institucioneve dhe organeve që inspektojnë ose monitorojnë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Nënkomisioni vlerëson se është e nevojshme ndjekja sistematike e respektimit të standarteve minimale të trajtimit të të miturve dhe të rinjve.
8. Vlerëson nevojën e angazhimit të Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore që të ndjekë përmbushjen e detyrimeve të organeve të qeverisjes vendore, në juridiksionin e të cilave ndodhen institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
9. Vlerëson nevojën e zbatimit të një politike penale që sheh dënimin me burgim si masa e fundit. Duke vlerësuar faktin se Këshilli i Lartë e Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor raportojnë në komisionin “Për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut”, do të ishte e rekomandueshme që kjo çështje të adresohet dhe të inkurajohet zbatimi i dënimeve alternative të dënimit me burgim, duke ofruar gjithë mbështetjen me burime njerëzore dhe financiare për këtë qëllim.
10. Kërkon që ministritë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të KPT dhe të Mekanizmit Kombëtar të informojnë Kuvendin e Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve jo më vonë se 6 muaj nga miratimi ka miratimi i këtij raporti. Gjithashtu, shërbimet e monitorimit të institucioneve të pavaruara, të informojnë në mënyrë sistematike Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.
11. Kërkon që brenda datës 17.07.2020 drejtuesit e institucioneve të monitoruara të dërgojnë një informacion me shkrim në adresë të Nënkomisionit lidhur me ecurinë e realizimit të të gjitha rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe KPT-së.

Nënkomisioni do të informojë komisionin “Për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut” lidhur me gjendjen dhe problematikat e konstatuara në tre institucionet e monitoruara dhe do të ndjekë në mënyrë sistematike përmbushjen e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht ose të pazbatuara.

**KRYETARE
VASILIKA HYSI**